



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I QARKUT VLORE

Nr. ____ Prot.

Vlore me, / / 2025

P/ VENDIM I ASAMBLESE

Nr..... date...../...../2025

"Për miratimin e Pasqyrave Financiare të Shoqërisë "Bajkaj Land" sha për vitin 2024"

Këshilli i Qarkut Vlorë, ne cilesinë e asamblesë së zakonshme të shoqërisë, në mbledhjen e dates/.....2025, në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Per Veteqeverisjen vendore, Nr, 9091 datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare"neni 81, pika 1, gërma e, dhe ë, pika 2, Ligjit Nr.8438 datë 28.12.1998 "Për tatim mbi te ardhurat"i ndryshuar, neni 27 "Mbartja e humbjeve" pika 1, neni 33/1, "Depozitimi i vendimit për miratimin vjetor dhe destinimi i fitimit" pika 1 dhe statusit të shoqërisë "Bajkaj Land" sha,


VENDOSI

1. Miratimin e Pasqyrave Financiare të vitit ushtrimor 2024,
2. Miratimin e Rezultatit Financiar dhe përdorimin e fitimit neto të realizuar si më poshte:

1	Fitim neto i realizuar	6,297,210
2	Për shtesa në kapitalin e shoqërisë	
3	Për kalimin në rezerva ligjore e statutore	
4	Për investime	
5	Fitime per tu shqërndarë	
6	Dividenti 15%	

3. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë për zbatimin e vendimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit 139/2015, "Per Vetëqeverisjen Vendore" neni 78 pika 3.

ERVIS MOÇKA
KRYETAR



KEI-AL
A U D I T I N G

Auditing & Related Services,
Accounting, Tax Advice and
Business

RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

Për : Asamblesë së Shoqërisë "Bajkaj Land" sh.a Vlorë
Shoqërisë "Bajkaj Land" sh.a Delvinë
Z. Feruz BASHO
Administrator i shoqërisë

Adresa: Njësia Administrative Vergo, Bashkia Delvinë

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare "Bajkaj Land" sh.a Delvinë të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2024, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur me datën 31.12.2024, si edhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë "Bajkaj Land" sh.a më datën 31 Dhjetor 2024, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombetare të Kontabilitetit (SKK).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen përgjegjësitë e audituesit për auditimin e Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Vijëmësia

Pasqyrave Financiare të shoqërisë janë përgatitur me parimin e vijëmësisë. Përdorimi i këtij parimi të kontabilitetit është i përshtatshëm përveç rasteve kur drejtimi ka për qëllim të likujdojë shoqërinë apo të ndaloj veprimtarinë e saj, ose kur nuk ka ndonjë alternativë tjetër. Si pjesë e auditimi tonë ne kemi arritur në konkluzionin se përdorimi i parimin të vijëmësisë është i drejtë, Drejtimi nuk ka identifikuar ndonjë pasiguri materiale që mund të ngrejë dyshime mbi aftësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijëmesi dhe për rjedhojë nuk ka përfshirë ndonjë rast të tillë në shënimet e pasqyrave financiare. Bazuar në auditimin tonë të pasqyrave financiare, as ne nuk kemi identifikuar ndonjë pasiguri materiale. Megjithatë, as Drejtimi i shoqërisë dhe as Audituesi nuk mund të garantojnë aftësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijëmesi.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe Organeve të Qeverisjes për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit që zbatohen në Republikën e Shqipërisë dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Drejtimi ka gjithashtu, përgjegjësinë për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar veprimtaritë në vijëmesi, duke dhënë për këtë qëllim, kur është rasti, informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijëmesinë nisur nga parimi kontabël i vijëmesisë, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë, të ndërpresë aktivitetet e saj, ose rasteve kur drejtimi nuk ka alternativë tjetër reale përveç likuidimit të shoqërisë.

Organet e ngarkuara me qeverisjen kanë përgjegjësinë për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona të auditimit janë: të arrijmë një siguri të arësyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi kanë ose jo anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport, i cili përfshin opinionin e audituesit. Siguria e arësyeshme megjithatë është një siguri e nivelit të lartë, ajo nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku pritet, që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Nje auditim i pasqyrave financiare në përputhje me SNA-të, kerkon qe ne si auditues te ushtrojmë gjykimin profesional dhe te ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku anomalie materiale si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arësyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Kur arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

AUDITUESI LIGJOR

Arqile Mëhtaku, AL/EKR

Licensë nr. 74 datë 31.01.2000

Ortak Angazhimi KEI-AL AUDITING

Bulevardi "Ismail Qemali" P455/1 Ap, 3 Vlorë



Vlorë më, 27/03/2025

SHENIMET SHPJEGUESE

Permbledhje e politikave dhe rregullave kryesore kontabel

a. Menyra e Pergatitjes se Pasqyrave Financiare

Pasqyrat Financiare te shoqerise jane pergatitur ne te gjitha aspektet e tyre materiale, sipas kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit te permiresuara . Pasqyrat financiare jane pergatitur duke perdorur bazat e vleresimit te specifikuara nga SKK per cdo tip te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve . Ne hartimin e pasqyrave financiare jane ndjekur dhe zbatuar politikat kryesore kontable te tilla si : Politika per njohjen e aktiveve, e detyrimeve, e te drejtave, e te ardhurave, e shpenzimeve si dhe vlerësimi i drejte i tyre, gjate hartimit jane respektuar parimet e kontabilitetit te cilat me te rendesishmet po i permendim si me poshte: Parimi i te drejtave te konstatuara, parimi i vijemësisë së veprimtarisë ekonomike, parimi i kujdesit dhe i kompesimit.Pasqyrat Financiare jane pergatitur bazuar ne parimin e koston hitorike duke u kombinuar me element te metodave te tjera dhe parimit te te drejtave te konstatuara.Pasqyrat Financiare te shoqerise jane pergatitur mbi supozimin e biznesit ne vijimesi, i cili merr parasysh se shoqeria do te vazhdoje ekzistencen e aktivitetit te saj ne nje te ardhme te parashikuar.Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale dhe e paraqitjes të pasqyrave financiare te Shoqërisë.

b. Rregullat per vleresimin e Aktiveve Afatgjata Materiale dhe Jo Materiale

Zërat e Aktiveve Afatgjata Materiale, përveç tokës, paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme i shtohen koston së AAM-së vetëm nëse ato përmbushin kriteret e përkufizimit të AAM-ve dhe kriteret për njohjen e aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar. Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor.

Kostot përfshijnë shpenzime qe janë kryer drejtpërsëdrejti për blerjen e aktivit. Kostot e aktiveve te ndërtuara nga vete shoqëria, përfshijnë koston e materialeve dhe te fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër qe lidhet direkt me vënien e aktivit ne kushte pune, si dhe kostot e çmontimit te zhvendosjes dhe te magazinimit te tyre ne vendndodhjen përkatëse.

Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentë kryesor) të aktiveve afatgjata materiale. Amortizimi i AAM-ve llogarite sipas normave te miratuara me Ligjin 8438 date 28/12/1998 "Per tatimin mbi te ardhurat " i ndryshuar. Norma e amortizimit per ndertesat eshte 5% te vleres se mbetur, makineri dhe paisje pune 5% te vleres se mbetur, mjete teknologjike 20% e vleres se mbetur, mjete transporti 20 % te vleres se mbetur, kompjutera dhe sistemet software 25% te vleres se mbetur, dhe AAM e tjera me 20 % te vleres se mbetur. Per AAJM norma e amortizimit eshte 15% te vleres lineare te tyre.

a. AAM e njesise ekonomike per periudhen ushtrimore paraqiten ne pasqyren e meposhtme:

Akte Afatgjata Materiale me vlere fillestare						
Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa	Shtesa	Pakesime	Gjendje
		01/01/2024				31/12/2024
1	Projekte	1,724,454				1,724,454
2	Toka	0				0
3	Ndertime	718,175				718,175
4	Makineri,paisje	613,224				613,224
5	Mjete transporti	180,388,286	2,556,300			182,944,586
6	Paisje kompjuterike	495,525	75,000			570,525
7	Inventar ekonomik	518,668				518,668
	Totali	184,458,332	2,631,300	0	0	187,089,632

Amortizimi A.A Materiale						
Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa	Shtesa	Pakesime	Gjendje
				amortizimi vjetor		
1	Projekte	1,357,689		154,660		1,512,349
2	Toka	0				0
3	Ndertime	118,942		29,962		148,903
4	Makineri,paisje	187,827		21,270		209,097
5	Mjete transporti	131,141,025		9,870,463		141,011,488
6	Paisje kompjuterike	271,958		60,258		332,216
7	Inventar ekonomik	222,903		53,496		276,399
	Totali	133,300,344	0	10,190,109	0	143,490,453
Toka						
Nr	Emertimi	VI kont neto	Sh rivleresimi	Shtesa	Pakesime	VI kont neto fund
1	Projekte	366,765	0	0	154,660	212,105
2	Toka	0	0	0	0	0
3	Ndertime	599,233	0	0	29,962	569,272
4	Makineri,paisje	425,397	0	0	21,270	404,127
5	Mjete transporti	49,247,261	0	2,556,300	9,870,463	41,933,099
6	Paisje kompjuterike	223,567	0	75,000	60,258	238,309
7	Inventar ekonomik	295,765	0	0	53,496	242,269
	Totali	51,157,988	0	2,631,300	10,190,109	43,599,180

Grantet qeveritare jo-monetare (SKK 10)

Një grant qeveritar mund të jetë në formën e transferimit të një aktivi jo monetar, si psh një terren ose burime të tjera, për t'u përdorur nga njësia ekonomike. Në këto rrethana është e zakonshme që të vlerësohet vlera e drejtë e aktivit jo monetar dhe të kontabilizohet si granti dhe aktivi me vlerën e drejtë. Një rrugë alternative që ndiqet ndonjëherë është që aktivi dhe granti të regjistrohen me vlerën nominale.

Paraqitja e granteve që lidhen me aktivet

Grantet qeveritare që lidhen me aktivet, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, duhet të paraqiten në pasqyrën e pasqyra e pozicionit financiar ose duke e njohur grantin si të ardhur të shtyrë ose duke zbritur grantin që merret nga vlera e mbartur e aktivit.

Dy metodat e paraqitjes në pasqyrat financiare të granteve (ose pjesëve të caktuara të granteve) që lidhen me aktivet, shihen si alternativa të pranueshme.

Njëra metodë njeh grantin si të ardhur të shtyrë e cila njihet si e ardhur në një mënyrë sistematike dhe racionale gjatë jetës së dobishme të aktivit.

b. Rregullat për vlerësimin e mjeteve monetare

Mjetet monetare përfshijnë, mjete monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, si dhe, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide me kontrata jo më të gjata se tre muaj, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë. Transaksionet në monedhë të huaj, që plotesojne kushtet në njohje, regjistrohen në monedhën funksionale, duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e menjëhershëm të këmbimit (spot) ndërmjet monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datën e trasaksionit, por shpesh përdoret një kurs këmbimi, i cili është i përafërt me kursin e datës së kryerjes së transaksionit, p.sh. një kurs mesatar i një jave ose një muaji, mund të përdoret për të gjitha transaksionet e kryera gjatë kësaj periudhe, në secilën prej monedhave të përdorura

c. Gjendja e mjeteve monetare ne fund te periudhes ushtrimore paraqitet ne pasyren e meposhtme:

Nr.	Emertimi bankes	Nr llogarise	Monedha	Vlera	Kursi këmbimit	Vlera totale
1	OTP BANK	00001245784	leke	14,945,427.41	1.00	14,945,427.41
2	Raiffesien Bank	0001421472	leke	478,575.00	1.00	478,575
	Totali					15,424,002.41

d. Rregullat për vlerësimin e inventarit

Inventari është paraqitur me vlerën me të ulët mes kostos dhe vlerës së realizueshme neto. Vlera e realizueshme neto është cmimi i shitjes i përlogaritur gjatë rrjedhës normale të biznesit pa koston e përlogarit të perfundimit dhe shpenzimet e shitjes. Kosto është llogaritur si vijon: Lendet e para me koston e blerjes dhe inventari i imët kosto blerje minus konsumin e llogaritur; Prodhime në proces me kosto në bazë të metodës së mesatares së ponderuar; Produkt i gatshëm me kosto në bazë të metodës së mesatares së ponderuar

e. Rregullat për vlerësimin e Parapagimit dhe shpenzimit e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra përfaqësojnë shpenzimet e kryera në vitin korent dhe i perkasin periudhave të ardhshme të njësisë ekonomike. Për këto shpenzime është ndjekur politika kontable kosto minus zhvlerësimet nëse ka të tilla.

g. Rregullat për vlerësimin e Huave e Parapagimeve

Huat dhe parapagimet të klasifikuar sipas zerave të pagueshme ndaj furnitorëve, ndaj punonjësve, detyrime tatimore, detyrime ndaj sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore, hua të tjera ndaj institucioneve të kreditit, janë të vlerësuar sipas dokumentit justifikues, fature tatimore ose kontratë e lidhur midis paleve sipas legjislacionit në fuqi.

h. Rregullat për vlerësimin e Kapitalit

Kapitali i njësisë ekonomike vlerësohet sipas vlerës kontable të kapitalit aksioner të emertuar në krijim të njësisë ekonomike, rezervave të krijuara në përputhje me statusin e shoqërisë dhe kërkesave ligjore të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ose të ndonjë ligji tjetër të aplikueshëm. Fitimet e pashpërndara që përbehen nga fitimet e akumuluarat minus pagesat e bera apo përdorimi i tij, dhe fitimi i vitit korent.

i. Rregullat e vlerësimit të Shpenzimeve direkte

Shpenzimet e njësisë ekonomike të vitit financiar përfaqësojnë shpenzimet e blerjes të mallrave, lendeve të para dhe të shërbimeve të konsumuara për veprimtarinë përsosë, koston e shërbimeve kryesore të vlerësuar me cmimin e blerjes dhe të vërtetuar me fatura origjinale e dokumenta të tjera kontable, shpenzimet që lidhen në mënyrë direkte me mallrat ose produktet të destinuar për shitje. Pagat shpërblimit dhe kompesimet monetare, sigurimet shoqërore të paguar nga njësia ekonomike të llogaritur mbi pagën që i perkasin periudhës kontable pavarësisht nga fakti nëse ato janë paguar ose jo. Shpenzimet e amortizimit që vijnë nga renia në vlerë e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale. Shpenzime të tjera të pa përfshira në zërat e mesipër por që lidhen me veprimtarinë kryesore të njësisë ekonomike.

Shpenzimet për blerje të kryera gjatë vitit ushtrimor paraqiten si më poshtë

Nr	Emertimi	Vlefë
1	AAJM projekte	0
2	AAM ndertesa	0
2	AAM inventar informatik	75,000
2	AAM inventar mjete transporti	2,556,300
3	Blerje materiale kryesore ndihmese, lende djegese dhe mallra	9,555,626
3	Shpenzime energjie, uji	221,478
4	Shpenzime sigurimi mjete	72,100
4	Shpenzime telefonike	105,953
5	Shpenzime mirembajtje dhe riparime të ndryshme	1,041,245
5	Shërbime kontable	203,940
6	Shpenzime të tjera	31,377
6	Totali	13,863,019
7	Deklaruar në FDP	13,863,019
8	Diferenca e deklarimit	0

Shpenzimet që i perkasin vitit ushtrimor paraqiten si më poshtë

Nr	Emertimi	Vlefë
1	Blerjet gjatë vitit ushtrimor	
2	Gjendja e mallrave në fillim të vitit	1,679,916
3	Gjendja e mallrave në fund të vitit	-1,226,820
4	Blerje materiale kryesore ndihmese, lende djegese dhe mallra	9,555,626
5	Shpenzime energjie, uji	221,478

6	Shpenzime sigurimi mjete	72,100
6	Shpenzime telefonike	105,953
7	Shpenzime mirembajtje dhe riparime te ndryshme	1,041,245
8	Sherbime personel jashte njesise (keshilli mbikqyres)	878,068
9	Shpenzime kontabel I miratuar	203,940
10	Paga	22,707,055
11	Sigurimet shoqerore	3,677,213
12	Shpenzime te tjera	76,535
13	Udhetim e dieta	71,661
14	Amortizimi i AAM-ve	10,190,109
14	SHPENZIME TE TJERA RRJEDHESE	
15	Taksa dhe tarifa vendore, institucioneve te tjera sig mjetesh	2,326,688
16	Sherbime bankare	33,450
17	Gjoha e penalitet	32,330
18	Totali	51,646,547
19	Shpenzime te perjashtuar per efekte fiskale	0
	Totali	51,646,547

j. Rregullat e vleresimit te te Ardhurave

Te ardhurat perfaqesojne shitjet neto e rrjedhimisht te ardhurat e perftuara nga kryerja e punimeve ne ndertim gjate periudhes kontable te vleresuar sipas standarteve te kontabilitetit, si dhe te produktit ne proces ndertimi. Regjistrimi sipas mases se realizimit te tyre dhe te lidhjes qe kane me ushtrimin e mbyllur kontabel, pavaresisht nese arketimi i tyre apo i nje pjese prej tyre do te ndodhe ne nje ushtrim pasardhes.

Ne grupin e te ardhurave te tjera per vitin ushtrimor pasyrohen ne tabelen e meposhtme:

Nr	Emertimi	Vlefte
1	Te ardhura nga aktiviteti kryesor	53,999,309
2	te ardhura nga aktiviteti dytesor 1 shitje mallrash	
3	te ardhura nga aktiviteti dytesor 2 prodhim i AAM Ndertesa	
4	te ardhura te tjera	
5	Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	
6	Totali	53,999,309
7	Deklaruar ne FDP	53,999,309

Ne grupin e te ardhurave te realizuar per vitin ushtrimor pasyrohen ne tabelen e meposhtme:

Nr	Emertimi	Vlefte
1	Te ardhura nga ndryshimi ne inventarin e produktit dhe prodhimit ne proces	0
2	Kliente per pagesat paradhenie sipas prenotimit paraprak	0
3	Te ardhura te tjera te shfrytezimit	0
4	Totali	0
5	Deklaruar ne FDP	0
6	Diferenca e deklarimit (Amortizimi i grantit)	0

Te ardhura te tjera financiare

Nr	Emertimi	Vlefte
2	Te ardhura te tjera (Amortizimi i grantit)	3,944,448
	Totali	3,944,448

jk. Rregullat e vleresimit te Shpenzimeve (Te Ardhurave) Financiare

Te ardhurat ose shpenzimet financiare jane klasifikuar ne te ardhura ose shpenzime nga interesat bankare, te ardhura te ineresit mbi hua, bono, marreveshje te qirase financiare Te ardhurat (shpenzimet) nga ndryshimi i kursit te kembimit, te kerkesave per te arketuar dhe detyrimeve per te paguar , si dhe gjendjet e likujditeteve ne monedhe te huaj qe lidhen me veprimtarine financiare investuese ne fund te periudhes financiare. Te ardhurat te tjera (shpenzime) nga rezultati i financimeve afatshkuterta, rezultati nga dividendi, rezultati nga rivlersimi i vleres se drejte etj.

II. Rregullat e vleresimit te Tatimi mbi Fitimin

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin vleresohen ne baze te rezultatit te periudhes financiare i llogaritur ne perputhje me dispozitat per tatimin mbi te ardhurat ne RSH per tatimin per fitimin . Shpenzimet per tatimin mbi fitimin perfshijne gjithë detyrimet per tatimin mbi fitimin e periudhes financiare.

Nr	Emertimi	Vlefta
1	Te ardhura totale nga shitja	53,999,309
2	Amortizimi I Grandit	3,944,448
3	Shpenzimet totale te ushtrimit	51,646,547
4	Shpenzimet e panjohura	0
5	Fitimi ushtrimor (+) Humbje (-)	6,297,210
6	Norma e tatimit mbi fitimin	15%
7	Tatimi mbi fitimin ushtrimor	0
8	Tatimi fitimi i shtyre	6,297,210
9	Pagesa paradhenie e kesteve te tatim mbi fitimin	0
10	Tatimi mbi fitimin per te paguar/ i paguar me teper	

m. Te dhenat per njesine ekonomike

Ne referim te Ligjit 25/2018 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe kerkesave te nenit 16 te ligjit po paraqesim numrin mesatar te punonjesve gjate periudhes raportuese, shumen e pagave qe jepen ne periudhen raportuese te anetareve te organeve ekzekutive, drejtuese dhe mbikqyrese, per shkak te pergjegjesive te tyre dhe cdo angazhim qe lind ose merret persiper ne lidhje me pensionet e ish antareve te ketyre organeve drejtuese. Emrin dhe seline per secilen prej njesive ekonomike, ne te cilat njesia ekonomike zoteron nje interes me pjesemarrje , duke treguar perqindjen e kapitalit te zoteruar, shumen e kapitali dhe rezervave, fitimin ose humbjen per periudhen e fundit raportuese .

Nr	Emertimi	Vlera
1	Nr mesatar i punonjesve te njesise ekonomike gjate periudhes raportuese	21
2	Shuma vjetore e pages se organeve drejtuese te njesise ekonomike	2,534,000
3	Shuma vjetore e pages se organeve mbikqyrese e te njesise ekonomike	1,082,008
4	Emri dhe selia e nje ne te cilen njesia zotron nje interes me pjesemarrje	nuk ka
5	% e kapitali te zoteruar ne interesin me pjesemarrje	100%

2. Organizimi i Kontabilitetit te njesise ekonomike

Kontabiliteti eshte i organizuar ne perputhje me Ligjin 25/2018 " Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare. Shoqeria ka ndertuar nje plan te llogarive me program exel per regjistrimin e dokumentave kontabel.

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Administratori i Shoqerise

Antoneta Mehilli

Feruz Basho